


BULETINI



JANAR 2024



Në janar u publikua raporti vjetor për vitin 2023, duke nxjerrë në pah arritjet e rëndësishme të OJQ ACDC gjatë gjithë vitit. ACDC vazhdoi fokusimin e saj në promovimin e drejtësisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në Kosovë. Duke u mbështetur në themelet e hedhura në vitet e mëparshme, OJQ ACDC inicioi seminare të shumta, hulumtime, trajnime, fushata mediale dhe konferenca. Për më shumë detaje, raporti vjetor i ACDC për vitin 2023 është i disponueshëm në faqen e internetit në të tri gjuhët.

 SRB

 ALB

 ENG

Infografia për vitin 2023 paraqet arritjet tona në fusha të ndryshme kyçe, duke përfshirë sundimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ofrimin e ndihmës juridike falas, mbrojtjen e mjedisit, promovimin e drejtësisë, luftimin e diskriminimit dhe nxitjen e bashkëpunimit ndëretnik.



Announcements

Në janar, shpallëm një Thirrje për punë praktike, duke ftuar për të aplikuar individë të rinj, ambiciozë të interesuar për të fituar përvojë pune të vlefshme dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

Gjithashtu, është publikuar edhe një thirrje tjetër për pjesëmarrje në punëtori për diversitetin kulturor. Kjo nismë fokusohet në ndërtimin e urave të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet aktivistëve të rinj kulturorë, me theks të veçant tek të rinjtë nga komunitetet pakicë në Kosovë.

Iniciativat Kërkimore:

Këtë muaj, filluam dy iniciativa kërkimore. E para synon të eksplorojë qëndrimet dhe perceptimet e banorëve të veriut të Kosovës në lidhje me gjuhën e urrejtjes. Qëllimi është të vlerësohet opinioni publik mbi iniciativat e mundshme që mund të kontribuojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve dhe reduktimin e kësaj tendence negative. E dyta, e realizuar në bashkëpunim me OJQ REC, fokusohet në qëndrimet dhe perceptimet e të rinjve dhe studentëve në Kosovë lidhur me bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve etnike.



OP EDs

Dy artikuj u botuan këtë muaj. E para, e titulluar "Midis dy zjarreve: Kosova në vorbullën e politikës dhe dialogut", nga Milica Ristovic, thekson se pavarësisht nga lojërat politike, dallimet fetare apo specifikat kulturore, të drejtat e njeriut dhe e drejta për liri janë elemente themelore që formojnë bazën e një shoqërie të drejtë. [LINK](#)

Artikulli i dytë, që trajton rëndësinë e çështjes gjuhësore në Kosovë, thekson rëndësinë e shqyrtimit të saj nga dy këndvështrime. Veljko Samarxhiq, Drejtor Ekzekutiv i CSI, hulumton problemin e barrierave gjuhësore në Kosovë dhe bënë thirrje për këmbëngulje aktive në të drejtat gjuhësore. [LINK](#)

Fushata në mediat sociale: Promovimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas

Gjatë gjithë janarit, OJQ ACDC vazhdoi fushatën e saj në rrjetet sociale duke promovuar shërbimet e ndihmës juridike falas në dispozicion të qytetarëve. Fushata kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për gamën e shërbimeve të ofruara nga ndihma juridike falas për qytetarët.

Fillimi i fushatës së re: Promovimi i Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK)



Për më tepër, në fillim të janarit, OJQ ACDC filloi fushatë të re kushtuar promovimit të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK). Billborde u vendosën në të gjithë Kosovën veriore duke theksuar dhe promovuar punën e IPK-së dhe duke ofruar informata kontaktuese që qytetarët t'i arrijnë ato. Fushata, që do të zhvillohet nga ACDC në periudhën e ardhshme, ka për qëllim ngritjen e vetëdijes për përpjekjet e IPK-së për të parandaluar sjelljet e papërshtatshme, korrupsionin dhe aktivitetet kriminale brenda Policisë së Kosovës, si dhe punën e tyre në ndërtimin e besimit në agjencitë e zbatimit të ligjit.

ACDC në Media

Aleksandar Rapajiq, drejtor programi në ACDC, për Kosovo Online, për vendimin preliminar të Qeverisë së Kosovës për anulimin e shpronësimit të tokës në komunat Leposaviq dhe Zubin Potok.



Slobodan Stoshiq, Menaxher Programi për Kosovo Online, për heqjen e dinarit në veri të Kosovës.



I ftuar në "Tempus" të KTV-së, Drejtori Ekzekutiv i ACDC, Dushan Radakoviq. Shikoni të gjithë emisionin në linkun e mëposhtëm.



NEW

Find us on 

www.facebook.com/acdcngo

